


12-02-2019

P.nr. 1154/17

NË EMËR TË POPULLIT


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues, Hysnije Gashi dhe Zyrtaren ligjore, Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit: [REDACTED] për shkak të veprës penale, veprat e renda kundër sigurisë së komunikacionit, te parashikuar nga neni 171 par. 5 lidhur me nenin 165 par. 3 lidhur me par. 1 të LPK-së, sipas aktakuzës PP/II nr. 32-4/2007 e dt. 14.11.2007, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me dt. 25.09.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit, Valdet Avdiu të akuzuarit, [REDACTED] dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av. [REDACTED] e dëmtuara [REDACTED] dhe përfaqësuesi i te ndjerave, [REDACTED] me datë 14.11.2018 mori dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Lipjan, i lindur më [REDACTED] në fshatin [REDACTED] nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], i martuar, baba i shtatë fëmijëve, pensionist invalidor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 11.11.1999, rreth orës 15:30 në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj, në fshatin Babush Muhaxherëve, Komuna Ferizaj, nuk i është përmbajtur dispozitave të komunikacionit dhe me këtë ka rrezikuar komunikacionin dhe jetën e njerëzve, duke menduar me mendjelehtësi se nuk do të shkaktohet pasoja e ndaluar, në atë mënyrë që i pandehuri duke vozitur veturën e tipit “Mercedes Benz”, Tipi 201, në kundërshtim me dispozitën e nenit 71.1 pika a të LSKRR-se, ka tejkaluar një autobus dhe pa pritmas ka dal në shiritin e veturës “Ford Eskort” që vinte nga drejtimi Ferizaj-Prishtinë, te cilin e drejtonte tani i ndjeri [REDACTED] i cili duke tentuar të i ik ndeshjesh, ka ikur në të djathtë por vetura “Mercedez Benz” e cila vinte nga kahja e kundërt, e ka

goditur ne anën e majtë veturën "Ford Eskord", e cila pas ndeshjes ka dal 10 metra jashtë rrugës ne anën e djathte duke u kthyer ne pozitën e kundërt te lëvizjes, me ç'rsat si pasojë e këtij aksidenti kane humbur jetën [REDACTED] dhe [REDACTED], kurse lëndime te rënda trupore ka pësuar [REDACTED], se dhe i pandehuri [REDACTED].

- me të cilën ka kryer veprën penale veprat e rënda kundër sigurisë së komunikacionit, te parashikuar nga neni 171 par. 5 lidhur me nenin 165 par. 3 lidhur me par. 1 të LPK-së

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe ligjit penal te aplikueshëm konform Rregullores 24/99 te UNMIKU-ut dhe nenit 5,11,14,33,34,38,41 si dhe nenin 365 te KPRK-së.

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDACTED]

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1 (një) VITI

Dënim i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Të dëmtuarit: përfaqësuesi ligjor i te ndjerëve [REDACTED] dhe [REDACTED] babi i tyre [REDACTED] dhe e dëmtuara [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen.450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e ekspertizës mjeko-ligjore në lartësi prej 55 €, super ekspertizës 450€, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimi e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

1.Historiku i procedurës

Prokuroria Publike e Qarkut Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP.nr.32-4/2007 të datës 14.11.2007, ndaj të akuzuarit: [REDACTED] për shkak të veprës penale veprat e rënda kundër

sigurisë së komunikacionit, te parashikuar nga neni 171 par. 5 lidhur me nenin 165 par. 3 lidhur me par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Qarkut ne Prishtinë me Aktgjykimin e saj me nr. PP.nr607/07 të datës 23,04,2008 e ka liruar nga akuza te akuzuarin [REDACTED].

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin e saj AP.nr 252/2008 me miratimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë ka anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer ne rigjykim.

Gjykata Themelore ne Ferizaj me aktgjykimin e saj me nr.P.nr.655/08 te datës ka shpallur fajtor te akuzuarin duke i shqiptuar dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 viteve

Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj PAI/2017 te datës 20.04.2017 ka anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer ne rigjykim.

Gjykata Themelore ne Ferizaj duke vepruar ne këtë qështje penale, caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësore ku prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës qe te akuzuarin te shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënimin e parapare me ligj për këtë vepër penale.

Përfaqësuesi i te ndjerëve [REDACTED] dhe e dëmtuara [REDACTED] ne shqyrtimin gjyqësor kane deklaruar se i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe kane parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari, [REDACTED], ne shqyrtimin gjyqësor ne mbrojtjen e tij ka deklaruar se data e sekte nuk i kujtohet por viti ka qenen 1999, gjersa ka qene duke e drejtuar veturën “Mercedez” ne magjistralen Prishtinë-Ferizaj, ne fshatin Babush, ku dukshmëria ka qene e mire dhe para automjetit te tij nuk ka vërejtur ndonjë veture tjetër, por nga mbrapa i ka parë dy vetura njëra veturë Golf 2 e cila veture e ka tejkalar automjetin “Ford” ne një distancë 50 metra dhe ato momente vozitësi i automjetit “Ford” ka filluar qe ta tejkaloj veturën Golf 2 dhe automjeti “Ford” ka kaluar ne enën e tij te lëvizjes dhe është përplasur me automjetin e tij.

Nga deponimi i te dëmtuarës [REDACTED] konstatohet se e dëmtuara ditën kritike se bashku me vëllaun e saj [REDACTED] dhe motrën [REDACTED] janë nisur për ne Prishtinë, e njëjta ka qene ulur ne ulësen e përparme te automjetit se bashku me vëllaun [REDACTED] i cili ka qene duke e vozitur automjetin, ndërsa motra e saj [REDACTED] ka qene e ulur ne ulësen e pasme te automjetit, me te arritur ne fshatin Babush i kujtohet se [REDACTED] ka qene duke vozitur ne nje shpejtësi 70-80 km ne

orë dhe ne atë moment ka vërejtur se nga ana e kundërt e lëvizjes ishte duke qarkulluar autobusi i "Kosova-Tranist" dhe menjëherë pas autobusit kishte dalur vetura "Merceds" me ngjyrë të kuqe e cila ishte afruar afërsisht 3 metra dhe kishte kaluar ne shiritin e tyre te lëvizjes ku vëllai i saj ■■■ ne atë moment kishte bërë titur dhe ishte munduar qe ti shmanget aksidentit, ka deklaruar se vëllai i saj ■■■ kishte tentuar qe te largohet ne anën e djathtë te lëvizjes dhe nga ai moment me nuk i kujtohet se çka ka ndodhur deri sa pas dy dite është zgjuar nga koma, me tej ka shtuar se para aksidentit vëllai i saj ■■■ nuk kishte tejkaluar ndonjë veture. Po ashtu ka deklaruar se nuk i kujtohet se ne ato momente ne rruge ka pasur ndonjë pengese apo grope, ju ka bashkëngjitur ndjekjes penale dhe ka parashtruar kërkesa pasurore juridike.

Nga deponimet dhe konstatimi i ekspertit te komunikacionit, ■■■ si dhe elaborimin i dhënë ne shqyrtimin gjyqësor e dt. 25.11.2015, duke pas ne dispozicion deklaratat e pjesëmarrësve dhe dëshmitareve dhe fotografitë e veturës se markës "Ford", ku shkresat e hetimit kane munguar siç janë: ekspertimi i vendit te ngjarjes si dhe fotografit e mjeteve te dëmtuara, duke u bazuar ne dëmtimet e automjetit "Ford" dhe largësinë e hedhjes se kësaj veture jashtë rrugës, kemi te bëjmë me shpejtësi te madhe goditëse ndërmjet te dy veturave kane qene ne shpejtësi se paku 80 km ne orë, sipas deklaratës se dëshmitareve dhe sipas dëmtimeve te automjetit "Ford" dhe "Mercedes", rezulton se vetura "Mercedes" ka dalur ne shiritin e majtë, shirit ky i destinuar për lëvizjen e mjeteve nga kahja e kundërt ne anën e kalimit te autobusit dhe si përfundim eksperti ka deklaruar se aksidenti ka ndodhur sipas varianteve te dëmtuarës ■■■ dhe se automjeti "Mercedes" ka kaluar ne shiritin e lëvizjes se automjetit "Ford" me çrast edhe e ka goditur veturën "Ford", me tej Eksperti i komunikacionit deklaron se shkaktar i këtij aksidenti është tejkalimi i pasigurt i vozitjes se veturës "B" ne këtë rast "Mercedisi", duke mos pasur distancën e mjaftueshme, te sigurt me mjetin te cilin përball kalon e qe ne atë moment nga kahja e kundërt lëvizte vetura "Ford", duke mos mundur te përfundoj tejkalimin dhe duke e detyruar vozitësin e mjetit përballë te shmanget ne anën e djathtë për ti ikur aksidentit ne pamundësi te evitimit për shkak te kësaj distance te pasigurt gjatësore është ndeshur me veturën ne përball kalim duke shkaktuar dëme te mëdha materiale, dy persona me fatalitet dhe një me lëndime te renda trupore.

Gjykata për te vërtetuar gjendjen faktike u bazua nga mendimi i ekspertit te komunikacionit ■■■ po ashtu i akuzuari ne konsultim me mbrojtësin e tij propozoi qe te behet Super ekspertiza nga grupi i eksperteve te komunikacionit ashtu qe sipas super ekspertizës

e datës 12.06.2018 e hartuar nga grupi prej tre ekspertëve për dhenjen e mendimit profesional ka tentuar që përmes simulimeve me ndihmën e softuerit të analizoj deklaratat e pjesëmarrësve në aksident (përmes Variacionit I dhe II) mirëpo nuk kanë arritur të nxjerrin rezultate me baze profesionale dhe bindëse të cilat dëshmojnë në mënyrë shkencore se njëri nga variantet e trajtuara është i besueshëm

Prandaj në mungesë të të dhënave të nevojshme nga vendi i aksidentit, nuk kanë qenë në gjendje të japin mendimin profesional lidhur me rrjedhën teknike të këtij aksidenti

Meqë superekspertiza e datës 12.06.2018 e konstatuar nga grupi i ekspertëve nuk e kanë kontestuar e as pohuar variantin e ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] i Gjykata ia falë besimin e plotë Mendimit të Ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] dhe e vlerësoi si bindës pasi që i njëjti është dhënë nga eksperti i lëmisë përkatëse dhe në harmoni me provat e tjera siç janë: ekspertiza mbi aksidenti të komunikacionit e dt. 31.10.2007, fletë lëshimi në ekspertizë i dt. 20.11.1999, dhe flete vdekje e dt. 11.11.1999, mendimi i Dr. [REDAKTUAR] lidhur me natyrën e lëndimit të të dëmtuarës [REDAKTUAR] dhe të pandehurit [REDAKTUAR], fotot e vendit të ngjarjes dhe elaborimit të dhënës në shqyrtimin gjyqësor ku i njëjti ka deklaruar “ se shkaktar i këtij aksidenti është tejkalimi i pa sigurt i vozitjes së veturës “B” në këtë rast “Mercedesit”, duke mos pasur distancën e mjaftueshme, të sigurt me mjetin të cilin përball kalon e që në atë moment nga kahja e kundërt lëvizte vetura “Ford”, duke mundur ta përfundoj tejkalimin dhe duke detyruar vozitësin e mjetit përballë të shmanget në anë të djathtë për të ikur aksidentit, në pamundësi të evitimit për shkak të kësaj distance të pasigurt gjatësore është ndeshur me veturën në përball kalim”,

Po ashtu Gjykata u shprehi besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarës –dëshmitares [REDAKTUAR] e cila ishte dëshmitare okulare, dhe të njëjtën dëshmi e vlerësoi si bindës pasi që nuk janë kontradiktore në mes vete dhe prova të tjera në këtë çështje penale dhe e njëjta përputhet me deklaratimet e Ekspertit të cila ka deklaruar se “ e ka parë se nga ana e kundërt e lëvizjes ishte duke qarkulluar autobusi i “Kosova-Tranist” dhe menjëherë pas autobusit kishte dalur vetura “Mercedes” me ngjyrë të kuqe e cila ishte afërsisht 3 metra dhe kishte kaluar në shiritin e tyre të lëvizjes ku vëllai i saj [REDAKTUAR] në atë moment kishte bërë titur dhe ishte mundur që të shmanget aksidentit”

Mbi gjendjen e tille faktike te vërtetuar gjykata vlerëson se ne veprimet e te akuzuarit formësohen te gjitha tiparet objektive dhe subjektive te veprës penale veprat e renda kundër sigurisë së komunikacionit, te parashikuar nga neni 171 par. 5 lidhur me nenin 165 par. 3 lidhur me par. 1 të LPK-së, pasi qe sipas vlerësimit te gjykatës aksidenti është shkaktuar me lëshimet e te akuzuarit [REDAKTUAR] i cili ne kundërshtim me dispozitën e nenit 71.1 te LSKR vozitur veturën e tipit “Mercedes Benz”, Tipi 201, ka tejkaluar një autobus dhe pa pritmas ka dal ne shiritin e veturës “Ford Eskort” qe vinte nga drejtimi Ferizaj-Prishtinë, te cilin e drejtonte tani i ndjeri [REDAKTUAR] i cili duke tentuar te i ik ndeshjesh, ka ikur ne te djathtë por vetura “Mercedez Benz” e cila vinte nga kahja e kundërt, e ka goditur ne anën e majtë veturën “Ford Eskord”, e cila pas ndeshjes ka dal 10 metra jashtë rrugës ne anën e djathte duke u kthyer ne pozitën e kundërt te lëvizjes, me ç’ rast si pasojë e këtij aksidenti kane humbur jetën [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kurse lëndime te rënda trupore ka pësuar [REDAKTUAR] se dhe i pandehuri [REDAKTUAR].

Mbrojtjen e te pandehurit se ka qene duke qarkulluar me automjetin e tij “Mercedes” ne magjistralen Ferizaj-Prishtinë ne fshatin Babush ka vërejtur nga prapa nga drejtimi Ferizaj-Prishtinë një veturë Golf 2 se ka tejkaluar automjetin “Ford” e qe vozitësi i veturës “Ford” ne ato momente ka filluar qe te tejkaloj veturën Golf dhe ne ate moment automjeti “Ford” ka kaluar ne anën e tij te lëvizjes dhe aty ka ardhur deri te përplasja.

Gjykata vlerëson se një mbrojte e tillë është e drejtuar ne drejtim te justifikimit te veprimit te tij inkriminues.

Mbrojtësi i te pandehurit Av. [REDAKTUAR] ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka mohuar veprën penal e cila i ngarkohet për faktin se shkaktar i aksidentit ka qene automjeti “Ford Eskord” i cili ka qene duke qarkulluar ne shiritin e tij te lëvizjes dhe ka vërejtur se nga ana e kundërt një automjet i tipit “Golf” ka filluar te tejkaloj një automjet tjetër dhe pas tij ka qene automjeti i viktimave “Ford Eskord” i cili ne pamundësi te tejkaloj automjetin para tij ka kaluar ne shiritin e tij te lëvizjes, poshtë ka deklaruar se nga super ekspertiza ne mungese te te dhënave nuk kane mundur te japin mendimin profesional lidhur me aksidentin.

Përcaktimi i dënimit

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit gjykata vlerësoi te gjitha ne kuptim te nenit 41 te Ligjit penal te aplikueshëm Rreg. 24/99 e UNMIK-ut, si rrethane lehtësuese për te pandehurin mori faktin se nga ai aksident ka pësuar lëndime te renda edhe i akuzuari, familjaret e

te akuzuarit kane shkuar ne varrimin e te ndjerëve dhe u kane kërkuar falje dhe kane shprehur keqardhje për rastin qe ka ndodhur, e këto rrethana duke i ndërlidhur me rrethanat tjera personale si moshë e shtyrë e te pandehurit, gjendjen e rende ekonomike, është baba i shtate fëmijëve, sjelljen korrekte gjate procedurës dhe duke marr parasysh kohën e kryerjes se veprës penale viti 1999, si rrethane renduese vlerësoi faktin se ne këtë aksident kane humbur jetën dy persona dhe njëra ka pësuar lëndime te renda trupore, si dhe janë shkaktuar dëme te konsiderueshme materiale, bindjen e gjykatëse se ky dënim është plotësisht i justifikueshme ne raport me peshën konkrete te veprës penale, me te cilin dënim do te arrihet qëllimi ndëshkimor qe te njëjtit ti parandaloje nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen si dhe te përmbajë persona te tjerë nga kryerja e veprave penale.

Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Të dëmtuarit: përfaqësuesi ligjor i te ndjerëve [REDACTED] dhe [REDACTED], prindi [REDACTED] dhe e dëmtuara [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore juridike te udhëzohen ne kontest civil.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen.450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e ekspertizës mjeko-ligjore në lartësi prej 55 €, super ekspertizës 450€, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimi e përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL,


P.nr.1154/17 i datës 14.11.2018

Zyrtare Ligjore:

Albana Ujupi

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.